



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prijmjen / Predato Received / Delivered	29.03.2023	3	viti god year
Organ / Institucija Organ / Jedinstvo Org. Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMBICK	3125/2023		1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr. 359/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi anëtarë me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 359/2023 të datës 14.02.2023 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_, me adresë banimi fsh, Gaçkë nga Komuna e Ferizajt, kundër organit të punësimit Inspektorati i Punës, në çështjen juridike „kërkesë nga marrëdhënia e punës”, në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 29.03.2023 mori këtë:

### V E N D I M

PËRFUNDON procedimi administrativ i iniciuar me ankesën A.nr. 359/2023 të datës 14.02.2023 të parashtruar nga ankuesi \_\_\_\_\_

### A r s y e t i m

Ankuesi \_\_\_\_\_, më datë 14.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1738/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me nr. 246/23 të datës 01.02.2023 të Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr. Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 23.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Inspektoratin e Punës. Ndërsa Këshilli, me datë 15.03.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkëngjitura të lëndës, ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për procedimi administrativ të filluar me ankesën e ankuesit, *sepse:*

Kolegji i Këshillit ka trajtuar pretendimet e ankuesit sa i përket marrjes së pushimit pa pagesë për arsyet të përgatitjes së provimit të jurispodencës si dhe refuzimin nga ana e Kryeinspektorit të Punës përmes shkresës me numër protokolli 246, të datës 01.02.2023.

Në bazë të provave të lëndës, si provë të rëndësishme Kolegji e ka vlerësuar kërkesën për dorëheqje nga shërbimi civil të parashtruar nga ankuesi me datë 10.03.2023, e të siguruar me përgjigje në ankesën e dërguar përmes e-mailit të datës 14.03.2023 nga Menaxheri i Personelit i Inspektoratit të Punës. Dorëheqja ankuesit i është aprovuar me datë: 22.03.2023 sipas vendimit me nr. Protokolli 25/2023, prandaj Kolegji i Këshillit ka konstatuar se objekti për të cilin ka filluar procedimi administrativ është bërë i pamundur për tu shqyrtuar dhe si rrjedhojë për të marrë vendim lidhur me pretendimet e ankuesit për pushim pa pagesë me qëllim të përgatitjes së provimit të jurispodencës. pretendimet ankimore të ankuesit [redacted] të parashtruar përmes A.nr. 359/2023 të datës 14.02.2023.

Nga konstatimet si me lartë Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimet e ankuesit që të anulohet Vendimi me Nr. 246/2023 i datës 10.02.2023 i të Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës, janë të pamundura ngase nuk kanë objekt shqyrtimi, sepse ankuesit me datën 10.03.2023, ka parashtruar v kërkesën për dorëheqje nga shërbimi civil, andaj objekti i ankesës është bërë i pamundur në bazë të dispozitat e nenit 104 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë"*, prandaj Kolegji i Këshillit, konstaton se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.359/2023 të datës 14.02.2023 të parashtruar nga ankuesi.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit dhe sipas nenit 104 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**LËNDA ME NUMËR A.nr.359/2023**

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet**

- Ankuesit [REDACTED]
- Kryeinspektorit të Inspektoratit të Punës
- Udhëheqësit të Personelit në Inspektoratin e Punës dhe;
- Arkivot të KPMSHCK-së;

